



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 159, Datë 02.07.2021

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS AREA PËR RISHIKIMIN E  
VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 116, DATË 30.04.2021**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 26, të Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.07.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 100/3 prot., datë 30.06.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve dhe Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, mbi “Shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 116, datë 30.04.2021”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për shtyrje të afatit të hyrjes në fuqi të vendimit nr.106, datë 02.07.2020”, ndër të tjera vendosi se OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijnë aplikimin e periudhës DRY RUN deri në datën 31.03.2021.
- Bordi i ERE me vendim nr. 116, datë 30.04.2021, Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës AREA për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit të bordit të ERES-s nr. 106, datë 02.07.2020, vendosi: *Mos pranimin e kërkesës së shoqatës AREA, për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020, “Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” me një periudhë shtesë 9 mujore, minimalisht deri më 31.12.2021.*
- Në vijim shoqata AREA nëpërmjet shkresës nr. 1810/108 prot., datë 01.06.2021, protokolluar në ERE me nr. 716 prot., datë 02.06.2021 parashtron kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 116, datë 30.04.2021, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës AREA, për shtyrjen e hyrjes në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020”.
- Shoqata AREA nëpërmjet shkresës nr. 1810/108 prot., datë 01.06.2021 parashtron ndër të tjera si më poshtë vijon:
  - *Konstatuam se më 26 Maj 2021, kërkesa jonë për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për një periudhë shtesë 9 mujore nuk është pranuar.*

- *Shumica e prodhuesve të vegjël e kanë kapacitetin e instaluar më të vogël se 5 MW dhe si pasojë sipas kontratës së shitblerjes së energjisë ato kanë patur detyrimin që të programojnë vetëm prodhimin vjetor apo mujor. Kërkesa për të dërguar prodhimin orar është një kërkesë teknike e rëndësishme e cila kërkon staf shtesë teknik për to dhe përmirësime teknike të komunikimit. Si pasojë një numër i rëndësishëm nuk i ka dërguar të dhënat për prodhimin orar, gjë e cila ka shkaktuar pasaktësi në llogaritjen si grup të disbalancave.*
- *Nga të dhënat që kemi për hidrocentralet e lidhura në shpërndarje ne nuk mund të marrim vlerën e prodhimit të ditës D në D+1 (paraprak) dhe ato definitive në D+10. Si pasojë, prodhuesit e vegjël janë jashtë kontrollit të saktësisë së programit të tyre, (në përputhje me rregullat e tregut).*
- *Gjatë zbatimit të testimit ne vëmë re se për shkak se mungon një platformë ku mund të dërgohen të dhënat dhe të shikohet në ditën tjetër ajo që është realizuar, dhe ku çmimi i disbalancës nuk është llogaritur në mënyrë automatike nga sistemi në varësi të gjendjes së sistemit dhe ofertave të OSHB-ve, ne konkludojmë se në këtë moment nuk mund të konsiderojmë se kemi një treg të organizuar balancimi dhe se sistemi ka nevojë për një periudhë më të gjatë të DRY -RUN, veçanërisht për prodhuesit e vegjël. Ne kërkojmë që deri në momentin që çdo prodhues me përparësi (PP) do të ketë mundësi të nominojë prodhimin 1 orë në avancë, të mos ngarkohen me kostot për gabimet në parashikimin për ditën D+1, për arsyen e vetme se hidrocentralet e vogla me derivacion apo impiantet fotovoltaike nuk mund të parashikojnë me saktësi prodhimin në një ditë në avancë për shkak të arsyeve që nuk varen nga to, si reshjet, temperatura, rrezatimi, shpejtësia e erës, ... etj. Në bazë të llogaritjeve tona parashikimi në 1 orë në avancë është i realizueshëm me një kosto minimale. Megjithatë, duke patur parasysh angazhimin njerëzor që duhet për të realizuar një detyrë të tillë, ne kërkojmë që hidrocentralet me kapacitet nën 2 MW dhe impiantet fotovoltaike të jenë të përjashtuar nga kostot e disbalancave të shkaktuara dhe të kenë si detyrim vetëm dërgimin e prodhimit orar në një ditë në avancë.*
- *Për sa me sipër parashtruar, AREA dëshiron të informojë se PP po bëjnë të gjitha përpjekjet që të jenë korrekt me zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve dhe kërkon ti tërheqë vëmendjen bordit të ERE-s edhe njëherë se DRY-RUN nuk është realizuar i plotë dhe se akoma nuk janë krijuar kushtet që prodhuesit me përparësi të paguajnë kostot e disbalancave ndërkohë që situata është e paqartë në disa dimensione, në transparencën e të dhënave, në dinamikën e shkëmbimit të të dhënave, në llogaritjen e disbalancave dhe në ngarkimin e tyre pa asnjë metodologji të qartë. Në këto kushte, duke mbajtur parasysh të gjitha arsyet ligjore të parashtruara më parë dhe argumentat shtesë të gjetura gjatë zbatimit të testeve gjatë muajit Prill dhe Maj, ne mendojmë se objektivi i Rregullave të Tregut të Balancimit që është "krijimi i një mekanizmi balancues eficient, transparent dhe jodiskriminues" nuk është realizuar akoma dhe se ne nuk shikojmë asnjë arsye përse të mos vazhdohet të punohet për realizimin e këtij objektivi dhe pastaj të konsiderohet i themeluar tregu i balancimit.*
- *Ne shikojmë gjithashtu se ERE është në kundërshtim të plotë me Nenin 2.3 të Rregullat e Tregut të Balancimit, i cili kërkon që të gjithë pjesëmarrësit e tregut të trajtohen në mënyrë jo-diskriminuese, në mënyrë transparente dhe korrekte. Prodhuesit me përparësi janë të vetmet subjekte të reja që preken nga hyrja në fuqi e*

*këtyre rregullave dhe pikërisht këto subjekte janë plotësisht jashtë zbatimit të Dry-Run, periodhe kjo që do të trainonte prodhuesit, nxirrte nevojat teknike që kërkonte sistemi dhe sqaronte të gjitha sa parashtruar më sipër.*

- Lidhur me sa parashtruar nga Shoqata AREA nëpërmjet shkresës nr. 1810/108 prot., datë 01.06.202, vlerësojmë se kërkesa e Shoqatës AREA, mbështetet në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenin 16 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të bordit të ERE-s.
- Në lidhje me paraqitjen e provave të reja, të tilla që të mund të çojnë bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm, shoqata AREA ka përcjellë vetëm parashtrimet e bëra me shkresën nr. 1810/108 prot., datë 01.06.2021, protokolluar në ERE me nr. 716 prot., datë 02.06.2021, me Lënde: “Kërkesë për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116, datë 30.04.2021 ”Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës AREA, për shtyrjen e hyrjes në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020”.
- Lidhur me sa parashtruar nga shoqata AREA me shkresën nr. 1810/108 prot., datë 01.06.2021, ERE nëpërmjet shkresës nr. 716/1 prot., datë 10.06.2021, i është drejtuar OST sh.a. për të dhënë vlerësimet përkatëse. OST sh.a., është operatori përgjegjës i ngarkuar nga ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të balancuar sistemin fizikisht, si dhe të administrojë procesin e nominimeve e llogaritjeve financiare. Shoqëria OST sh.a., operon tregun nëpërmjet platformës elektronike për menaxhimin e tregut DAMAS.
- Në vijim OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 3525/2 prot., datë 15.06.2021, ka parashtruar ndër të tjera:
  - *OST sh.a., në cilësinë e operatorit të sistemit është palë qendrore për qëllim të mekanizmit balancues dhe është përgjegjëse për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të balancuar sistemin fizikisht dhe të administrojë procesin e llogaritjeve financiare. Gjithashtu OST operon tregun nëpërmjet platformës elektronike për menaxhimin e tregut DAMAS, e cila aksesohet nga të gjitha palët përgjegjëse për balancim që janë regjistruar në OST sh.a. konform akteve rregullatore në fuqi.*
  - *Për sa i përket llogaritjes së disbalancave apo dhe çmimit të disbalancës nga ana e OST, llogaritjet kryhen në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike (RrTShB), të miratuara me Vendimin e ERE Nr. 106 datë 02.07.2020. Përkatësisht, Aneksi 12, ku specifikohet i detajuar mënyra e llogaritjes për çmimin e disbalancave, i cili ka si komponent në mënyrën e llogaritjes çmimin e energjisë balancuese i cili përcaktohet nga procedurat e tenderave për prokurimin e energjisë balancuese konform rregullave në fuqi, ku ky proces menaxhohet nëpërmjet platformës elektronike DAMAS. Komponent tjetër i përcaktimit të çmimit të disbalancave është edhe gjendja e rregullimit e cila gjenerohet nga sistemi Scada në mënyrë automatike dhe komponenti i fundit në llogaritjen e çmimit të disbalancave është komponentja nxitëse e cila konform rregullave në fuqi përcaktohet nga një procedurë transparente e miratuar nga OST dhe e përcjellë tek të gjithë palët përgjegjëse për balancim gjithashtu e*

*publikuar ne faqen zyrtare të OST.*

- Lidhur me sa parashtruar nga AREA, për HEC-et me fuqi të instaluar më të vogël se 5 MW, dhe Kontratën për shit - blerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike vlerësojmë se: Kontrata për shit - blerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.06.2016, të bordit të ERE-s, ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.09.2016, ndryshuar me vendimin nr. 255, datë 24.12.2018, në Nenin 5, Programet e Livrimit, pika 5, përcakton: *“Devijimet nga programet e paraqitura do të trajtohen ne përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike apo çdo akti tjetër të miratuar nga ERE për këtë qellim”.*
- Për më tepër ligji nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, në nenin 99, pika 1, përcakton qartë se: *“Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike”.*
- Gjithashtu, ligji nr. 7/2017 *“Për nxitjen e përdorimit të energjive nga burime të rinovueshme”* në nenin 8, pika 4, përcakton se: *Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike janë përgjegjës për balancimin. Prodhuesit bëhen palë përgjegjëse për balancimin, duke nënshkruar një kontratë me Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit të një palë tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut dhe procedurat përkatëse të miratuara nga ERE, në konsultim me Sekretariatit të Energjisë.*
- Operimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike për pjesëmarrësit e tregut ka filluar që nga 1 Janari 2018 dhe deri në 1 Prill 2021 është realizuar nëpërmjet aplikimit të Rregullave të Përkohshme të Mekanizmit Balancues të Energjisë Elektrike, të miratuara nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 193, datë 24.11.2017.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Në vijim bordi i ERE-s me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, ndër të tjera vendosi se OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijojnë aplikimin e periudhës Dry Run deri në datën 31.03.2021. Periudha 9 mujore e Dry Run e përcaktuar në vendimet e bordit të ERE-s, duhej të përdorej nga të gjithë pjesëtarët e tregut për të marrë masat e nevojshme përfshi dhe gjetjen e stafit apo përmirësimet e nevojshme teknike të cilat janë detyrim i të licencuarve që operojnë në tregun e energjisë elektrike.
- Lidhur me procesin e nominimeve në D + 1 apo D + 10, si dhe stafin teknik të nevojshëm të parashtruar nga AREA vlerësojmë se: Procesi i parashikimit dhe i programimit për prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, si dhe për çdo pjesëmarrës tjetër në tregun e energjisë elektrike është një detyrim që duhet të përmbushet nga vetë prodhuesit. Ky proces realizohet nëpërmjet stafeve teknike të kualifikuara dhe pajisjeve të komunikimit që duhet të sigurohen nga vetë prodhuesit me përparësi.
- Lidhur me procesin e trajtimit të barabartë të pjesëmarrësve të tregut të parashtruar nga shoqata AREA, vlerësojmë se: Sikurse evidentoni dhe në shkresën nr. 1810/108 prot., datë 01.06.2021, Neni 2.3, të Rregullat e Tregut të Balancimit, përcakton se të gjithë pjesëmarrësit e tregut të trajtohen në mënyre jo-diskriminuese. Në këtë prizëm ERE ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë*

*elektrike*”, i ndryshuar, të përcaktuara në nenin 98, pika 1, për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë, të cilat në pikën 2.3, garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, në respekt të përcaktimeve të nenit 18, pika 1, gërma “d”, e ligjit 43/2015.

- Në të njëjtën kohë në shkresën nr. 1810/108 prot., datë 01.06.2021 të shoqatës AREA, parashtrohet kërkesa lidhur me impiantet fotovoltaike të energjisë elektrike. Në këto rrethana deri aktualisht nuk rezulton të keni bërë me dije në ERE se AREA përfaqëson këta prodhues të energjisë elektrike. Në këto rrethana do të duhej kërkojmë të na bëni me dije se cilët janë prodhuesit e energjisë elektrike që përfaqësohen nga Shoqata AREA, si dhe të depozitoni në ERE autorizimet përkatëse të lëshuara nga këta prodhues të energjisë elektrike për tu përfaqësuar nga Shoqata AAREA në ERE, në mënyrë që AREA të legjitimohet si një palë me interes direkt në këtë përfaqësim.
- Lidhur me sa është parashtruar nga shoqata AREA mbi platformën IT dhe llogaritjen e çmimit të disbalancave, vlerësojmë se ERE nëpërmjet shkresës nr. 716/1 prot., datë 10.06.202, i është drejtuar OST sh.a., për të dhënë vlerësimet përkatëse. Shoqëria OST sh.a. është operatori përgjegjës i ngarkuar nga ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë”, i ndryshuar, për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të balancuar sistemin fizikisht, si dhe të administrojë procesin e nominimeve e llogaritjeve financiare.
- Në vijim OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 3525/2 prot., datë 15.06.2021, ka përcjellë vlerësimet përkatëse ku bën me dije se llogaritja e çmimeve bëhet bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike (RrTShB), të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020. Përkatësisht Aneksi 12 ku specifikohet me detaje mënyra e llogaritjes së çmimit të disbalancave si dhe proceseve automatike për të dhënat që sigurohen nga Sistemi SCADA. Në të njëjtën kohë OST sh.a. vijon punën për të bërë përmirësime në platformën elektronike DAMAS, për të cilat OST sh.a. është duke punuar me kontraktorin e platformës për të lehtësuar çdo proces që menaxhohet nga platforma. Kjo për faktin se procesi i realizimit të tregut të balancimit me platformë është një proces dinamik dhe kërkon përshtatje dinamike të çdo elementi të nevojshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi :**

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqatës AREA paraqitur me shkresën nr.1810/108 prot., datë 01.06.2021, me objekt: “Kërkesë për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116, datë 30.04.2021 "Për shqyrtimin e kërkesës së shoqatës AREA, për shtyrjen e hyrjes në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020”.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqatën AREA për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**